




Pranuar / Dorezuar Primijsno / Predato Received / Delivery	26.12.2018	8	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtetjese Prilog Appendix	Sasra Kolicina Quantity
SKPM SHOK	7992/2018		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

Anr. 730/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Lela Petkovic dhe Malsore Gashi – Bajraktari-anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.730/2018, të datës 09.11.2018, së ankuesja Nadije Ajazaj, me adresë banimi fsh Zhur, nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.12.2018, mori këtë

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa A. Nr.730/2018, e datës 09.11.2018, e parashtruar nga ankuesj Nadije Ajazaj.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit, me datë 25.07.2018, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën „Drejtor i SHFMU „ Dëshmoret e Zhurit”, në Prizren në Komuna e Prizrenit, nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil.

Komuna e Prizrenit me datë 25.07.2018, ka shpallur konkursin për pozitën „Drejtor i SHFMU,, Dëshmoret e Zhurit, në Komunën e Prizrenit. Ankuesja Nadije Ajazaj me datë 27.09.2018, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Prizrenit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prizrenit, me datë 22.10.2018, me numër protokolli 02-146136, ka nxjerr vendim me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja Nadije Ajazaj, e pakënaqur me vendimin me numër protokolli, 02-146136, me datë 22.10.2018, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prizrenit, me datën 09.11.2018 me numër protokolli 6703/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka parashtruar ankesë me pretendimet ankimore se procedurat e rekrutimit për



pozitën ‘ Drejtor i SHFMU ,, Dëshmoret e Zhurit, në Komunën e Prizrenit është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Prizrenit.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.11.2018 A nr. 9703/2018, me numër protokolli 7046/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 22.10.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; vendimi i Këshillit i datës 05.12.2018, me numër protokolli 351/2018; Ankesa e datës 27.09.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; kërkesë e datës 25.10.2018; Vërtetim i datës 08.08.2018; Diplomë e datës 25.02.2018; Certifikatë e datës 4.11.2001; Vendimi i datës 05.12.2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuses Nadije Ajazaj , **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se në bazë të raportit me rekomandim të kolegjit për Vëzhgim, Këshilli me vendimin e datës 05.12.2018, ka aprovuar zhvillimin e procedurave të rekrutimit, për pozitën „Drejtor i SHFMU ,, Dëshmoret e Zhurit, në Komunën e Prizrenit, me arsyetimin se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar ne pajtim me rregullat dhe parimet e Ligjit Nr. 03/ L – 149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, .

Kolegji për shqyrtim e ankesave, ka konstatuar se pala e pakënaqur kundër vendimit të Këshillit, ne rastin e nxjerrjes se vendimit, të nivelit drejtues, duhet të veprojë ne pajtim neni 19, paragrafi 8, Ligji nr. 06/l -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se; **8. Vendimi i Këshillit për procedurën e përzgjedhjes së nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër këtij vendimi palët në procedurë kanë të drejtë të iniciojnë konflikt administrativ, në pajtim me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ**”. Kolegji për shqyrtimin ankesave, ka konstatuar se palët e pakënaqur me vendimin e Këshillit në Nivelin drejtues, mund të paraqesin padi konflikt administrativë ne pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 730/2018,**

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses Nadije Ajazaj;
- Kryetarit të Komuna e Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

